



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1167/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Valbone Keka – Kandidate për Anëtare të Kuvendit Komunal në Kamenicë, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të manipulimit me vota, të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat: Anr.1167, Anr.1168, Anr.1169, Anr.1170, Anr.1171, Anr.1172 Anr.1173, Anr.1174, të datës 03.12.2013, të Valbone Keka – Kandidate për Anëtare të Kuvendit Komunal në Kamenicë

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.1167, Anr.1168, Anr.1169, Anr.1170, Anr.1171, Anr.1172 Anr.1173, Anr.1174, me datë 03.12.2013, nga Valbona Keka nga Kamenica në të cilat ankesa pretendohet se ka pasur pa rregullsi dhe keqpërdorime të shumta gjatë procesit të votimit nëpër qendrat e vendvotimit QV në Kamenicë.

- Në ankesën Anr1167/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në Qendrat e Votimit QV 1001X/01R, 1001X/02R, 1001D/02R, 1001X/03R janë bërë manipulime me votat. Parashtruesja e ankesës e ka bashkangjitur një deklaratë të dt. 03.12.2013 nga e njëjta Valbona Keka ku theksohet se, dyshoj se më janë keqpërdorur, manipuluar dhe vjedhur votat nga përonat e pa përgjegjshëm gjegjësisht komisionarët në VV, të njëjtit janë të cekur në ankesë. Më tutja ka shtuar se, duke u bazuar nga përvoja e zgjedhjeve të kaluara të vitit 2009, ku në të njëjtën mënyrë pasë rinumërimin kamë dalë fituese, shpresoj që do ta merrni parasysh ankesën time . Parashtruesja e ankesës krahas deklaratës e ka bashkangjitur një fletëlistë të personave në cilësi të kandidatëve për Asamble Komunale në Kamenicë.
- Në ankesën Anr.1168/13 të datës 03..12.2013, pretendohet se në vendvotimet VV 1030D/01R, 1030D/02R, 1030D/03D. janë bërë manipulime me votat. Parashtruesja e ankesës e ka bashkangjitur një fletëlistë të personave në cilësi të kandidatëve për Asamble Komunale në Kamenicë.

- Në ankesën Anr.1169/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV1009D/01R, 1009D/02R, 1009D/03R janë janë bërë manipulime me votat. Parashtruesja e ankesës e ka bashkangjitur një fletëlistë të personave në cilësi të kandidatëve për Asamble Komunale në Kamenicë.
- Në ankesën Anr.1170/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV 1026D/01R, 1026D/02R, 1026D/03D 03R janë janë bërë manipulime me votat. Parashtruesja e ankesës e ka bashkangjitur një fletëlistë të personave në cilësi të kandidatëve për Asamble Komunale në Kamenicë.
- Në ankesën Anr.1171 të datës 03. 12.2013, pretendohet se në në QV 1024D/01R, 1024D/02D, 1024D/04R , janë janë bërë manipulime me votat. Parashtruesja e ankesës e ka bashkangjitur një fletëlistë të personave në cilësi të kandidatëve për Asamble Komunale në Kamenicë.
- Në ankesën Anr.1172/13 të datës 03. 12.2013, pretendohet se në QV1008D/01R, 1008D/02D janë janë bërë manipulime me votat.
- Në ankesën Anr.1173/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV 1022D/01R, 1022D/02D janë bërë manipulime me votat.
- Në ankesën Anr. 1174/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV 1023/01D janë bërë manipulime me votat.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi Komisionin Qendror Zgjedhor (KQZ) me datën 04.12.2013, në lidhje me ankesat : Anr.1167, Anr.1168, Anr.1169, Anr.1170, Anr.1171, Anr.1172 Anr.1173 për shkak të mungesës së votave për QV, prandaj ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 05.12.2013 deri në ora 10:00.

PZAP-i nuk e pranoi përgjigjen e kërkuar nga KQZ-ja sipas afatit të caktuar ligjorë.

Bazuar ne nenin 6.3 të “Rregullave dhe Procedurave” të PZAP-it, në të cilin parashihet se: “Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë”. Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërshënuara dhe ti trajtoi si një ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesat gjeti se:

Ankesat janë të pa bazuara

Pretendimet ankimore nga ana e Valbona Keka nga Kamenica, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor, ku ka theksuar se janë bërë pa rregullsi dhe keqpërdorime të shumta si dhe manipulime të votave gjatë procesit të votimit nëpër QV në Kamenicë, mirëpo nuk është ofruar asnjë provë relevante nga ana e palës ankuese, me të cilat do të mund të vërtetoheshin shkeljet e supozuara.

Prandaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se kanë ndodhur dhe janë evidentuar pa rregullsi dhe keqpërdorime gjatë procesit të votimit në QV, të lartcekurat nga parashtruesi i ankesës, PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore janë të përgjithshme dhe të pa qarta për tu vërtetuar dhe ankesat e lartpërmendura u refuzuan si të pa bazuara, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesat e lartë përmendura u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 1167/2013 më datën 06.12.2013

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Këshillë juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.